



**“Ne e zbritëm Kuranin në një natë të bekuar. Vërtet, Ne gjithmonë kemi qenë paralajmërues.”**<sup>[1]</sup> Shihe vëlla i dashur dhe ti oj motër e nderuar se si Allahu i bëri bashkë shumë begati në Natën e Kadrit!

Kur’ani është i bekuar, atë ia zbriti Xhibrili, meleku më i bekuar, njeriut më të bekuar, Muhammedit, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të.

Ndërsa, dhuruesi i të gjitha begative, pa dyshim që është Allahu, i Lartmadhërishmi. Andaj, është shumë me rëndësi, që muslimani të bëjë përpjekje të mëdha për të arritur bereqetin e kësaj nate, në mënyrë që të përfitojë nga ky bereqet në këtë botë, në jetën e varrit dhe në botën e amshueshme.

Dr. Abdullah El-Gufejli

**“Melekët dhe shpirti (Xhibrili), me lejen e Zotit të tyre, zbresin në këtë natë.”**<sup>[2]</sup> Zbritja e melekëve në tokë nënkupton zbritjen e mëshirës, hajrit dhe bereqetit, prandaj moshyrja e melekëve në ndonjë vend është argument se në atë vend nuk ka hajr dhe bereqet, siç janë vendet në të cilat gjenden fotografi të ndaluara.

Shejh Ibën Uthejmin

**“E kush mund të ta shpjegojë ty se ç’është nata e Kadrit?”**<sup>[3]</sup> Me sa karakteristika madhështore u stolis kjo natë! Madhështia e atij që zbret në të (Kur’anit), madhështia e kohës, madhështia e adhurimit, madhështia e atyre që zbresin në të (melekëve), madhështia e dhënies pa kufi, dhe, misku i tërë kësaj është: **“Paqe është ajo deri në lindjen e agimit.”**<sup>[4]</sup> Ah, të mjerët ata që anashkaluan këtë natë! Ah, të mjerët ata që nuk hynë në radhët e ambiciozëve...!

Prof. Dr. Nasir El-Umer

Përktheu: Jusuf Kastrati

Përmbledhi: Qendra “Tedebbur” për Studime dhe Konsultime, Riad

---

<sup>[1]</sup> (Sureja ed-duhan: 3).

<sup>[2]</sup> (Sureja el-kadr: 4).

<sup>[3]</sup> (Sureja el-kadr: 2).

<sup>[4]</sup> (Sureja el-kadr: 5).